

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ka bërë të ditur se 290 persona, shumica shqiptarë të Kosovës, janë arrestuar në 48 orët e fundit përderisa po provonin ta kalonin ilegalisht kufirin.

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë ka bërë të ditur se 290 persona, shumica shqiptarë të Kosovës, janë arrestuar në 48 orët e fundit përderisa po provonin ta kalonin ilegalisht kufirin Serbi- Hungari, raporton agjencia e lajmeve Beta.

Arrestimet janë konfirmuar nga ministri i Punëve të Brendshme i Serbisë, Nebojsa Stefanoviq gjatë një konference për shtyp në Beograd.

"256 raste për kundërvajtje dhe 15 kallëzime penale janë dërguar në gjykatë për personat e dyshuar për kontrabandë me njerëz ndërsa janë konfiskuar 15 vetura", tha Stefanoviq.

"Secili që e keqpërdor lirinë e lëvizjes është duke bërë shkelje", tha ministri Stefanoviq, transmeton lajmi.

Ai u shpreh se gjatë ditës së sotme do ta takojë në Beograd drejtorin e policisë gjermane për të diskutuar për "emigrantët ilegalë dhe azil-kërkuesit fals".